



SBASHK Arsimimi sot

Maj, 2023

Gazeta elektronike

Një aktivitet i veçantë me Qendrën Amerikane të Solidaritetit SBASHK njihet me përvojat amerikane për grevat dhe protestat



Duke dëshmuar gjithë respektin për angazhimet dhe përkushtimin e SBASHK-ut në shërbim të anëtarësisë, Qendra Amerikane e Solidaritetit me seli në Tiranë vazhdon bashkëpunimin me sindikatën tonë duke organizuar trajnime e seminare që kanë për qëllim forcimin e zërit sindikal. Me angazhimin e drejtorit të kësaj Qendre Steven McCloud u realizua seminar 3 ditor me pjesëmarrjen e udhëheqësve sindikalë nga të gjitha nivelet. Kishte ardhur nga Uashingtoni gazetarja dhe drejtoresha për komunikim në Qendrën Amerikane të ... (faqe 4)

Aktivitet i veçantë i sindikatave të Ballkanit në Maqedoninë e Veriut

I pranishëm edhe Ministri i Arsimit të Maqedonisë së Veriut Jeton Shaqiri

Kishin punuar gjatë duke bërë hulumtime ... (Faqe 6)

Bisedë me kryetarin e Kuvendit të Sindikatës së Arsimit Parauniversitar të Pejës, Isuf Lajçi
Të bashkuar përballuam shumë sfida të kohës



Isufi është mësimdhënës ... (faqe 3)

Kuvend zgjedhor në Skenderaj
Respekt për angazhimet e kolegut Polaci, përgëzime Kryetarit të ri Shpend Rexha



Në Skenderaj, të shtunën e 13 majit ... (faqe 5)

Edhe një angazhim i SBASHK-ut në shërbim të anëtarësisë
Marrëveshje për zbritje të çmimeve për shërbime në Academic English Center



Në ambientet e SBASHK-ut përmes ... (faqe 6)

Editorial

Me unitet përballohen të gjitha sfidat



SBASHK-u në më shumë se tri dekada u dëshmuar si sindikatë e organizuar mirë dhe si zë i fuqishëm i anëtarësisë. Në faqet e historisë së arsimit shqip SBASHK zë vend meritore sepse në gjithë vitet e okupimit me sakrificë sublime të veprimtarëve sindikalë dhe të anëtarësisë arriti ta ruaj rrugëtimin e shkronjave shqipe. Kjo sakrificë bëri që sindikata jonë dhe gjithë punëtorët e arsimit të gëzojnë respekt të lartë të sindikatave nga shtetet mike, të cilat u gjenden pranë nesh dhe u kthyen në zë të fuqishëm kudo në botë për të drejtat tona legjitime.

Edhe në vitet e pasluftës u përballëm me shumë sfida dhe zhvilluam shumë aktivitete në shërbim të anëtarësisë. Arritjet janë të shumta dhe me kalimin e kohës ato, nganjëherë edhe harrohen pa qëllim. Arritëm me dialog me qeverinë të njihën vitet e 90-ta si kontributdhënëse dhe kështu pjesa më e madhe e anëtarësisë me këto vite të pranuarë gëzon pensionin e punës.

Arritëm me dialog e me plot debate të nxehta të kemi Ligjin për punëtorët e arsimit shqip të Republikës së Kosovës për vitet e 90-ta dhe kolegët e pensionuar gëzojnë shtesë në pension. Arritëm me punë e përkushtim të kemi edhe Kontratë Kolektive të Arsimit duke i përfshirë edhe Universitetet, kontratë kjo që u sollti mjaft benefite anëtarësisë siç janë shujta, pagat jubilarë, pagat përcjellëse, ruajtja e normave të punës, por edhe të drejta të tjera të garantuara. Dikush edhe mund të thotë se këto u realizuan përmes gjykatave, por po të mos ishte Kontrata Kolektive një gjë e tillë nuk do të realizohej dot. Arritëm t'i mbrojmë punëtorët e arsimit nga tendenca për testin me shkrim të njohurive që do të ishte degradues e nënçmues.

Shënuam bashkë edhe arritje të tjera dhe tani e sa kohë kur Qeveria e inatosur nga uniteti ynë mendoi se si do të na dëmtonte rëndë e të na shuante fare, duhet të shtojmë edhe pak angazhimet dhe të reregjistrohemi përmes eKosova. Është ky proces paksa i ndërlikuar, por ata që kanë vështirësi duhet kërkuar ndihmë nga kolegët që kanë njohuri më të mëdha me kompjuterin dhe internetin. Bashkë do të përballemi më lehtë me sfidat dhe do të shënojmë arritje të reja.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë, mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

www.sbashk-rks.org

Mos hezitoni të na jepni sugjerime për përfshirjen edhe të ndonjë rubrike në interes të antarësisë në gazetën e juaj elektronike Arsimi SOT.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbim të antarësisë, së shpejti do të oftojmë shërbime këshilla për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në uebfaqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

Botues: Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK) përfaqëson mbi 24.000 anëtarë në tërë territorin e Kosovës duke përfshirë edhe komunitetet, SBASHK është anëtare e Edukimit Ndërkombëtar që nga viti 1996 me drejta të plota.

Email: info@sbashk-rks.org

Tel: +383 (0) 38 226 940



Intervista

Bisedë me kryetarin e Kuvendit të Sindikatës së Arsimit Parauniversitar të Pejës, Isuf Lajçi
Të bashkuar përballuam shumë sfida të kohës



Isufi është mësimmshënës i matematikës në shkollën “Dardania” të Pejës. Gëzon respekt meritor për punën dhe angazhimin nëpër vite e dekada në arsimimin dhe edukimin e brezave. Ai që nga fillimet e rrugëtimit të SBASHK-ut ka qenë i angazhuar në aktivitete sindikale. Me punë e angazhim e duke pasur mbështetjen edhe të shumë veprimtarëve sindikal në Pejë janë shënuar arritje të vazhdueshme në shërbim të anëtarësisë. Zhvilluam një bisedë me Isufin dhe po e prezantojmë në këtë numër të gazetës sonë.

Fillimisht Isufin e ngacmojmë pak për ta nxitur të flas me një ton paksa të ngritur ashtu si e ka zakon. E kthejmë në kohët e kaluara e me plot sfida. Isufi me krenari flet për vitet e 90-ta duke kujtuar gjithë ato angazhime të punëtorëve arsimor në realizimin e obligimit ndaj atdheut për mësimin shqip në shkolla e Pejës e kudo në Kosovë. Isufi kujton edhe ditët e themelimit të SBASHK-ut dhe përballjen me gjithë ato sfida. Nuk preferon të përmend emra me arsytimin e drejtë se janë shumë veprimtarë sindikalë të asaj kohe dhe se mund të harroj ndonjë prej tyre. Por, ai duke kthyer kujtesën për ato kohë

shprehet se ndjehet krenar me gjithë angazhimet e tij dhe të SBASHK-ut. “Të bashkuar përballuam shumë sfida të kohës”, shprehet Isufi dhe sikur edhe një herë kthehet në vitet e 90-ta, që janë vite të lavdisë së arsimit shqip në Kosovë.

Isufi me krenari flet edhe për vitet e para të pasluftës dhe përmend me krenari gjithë atë përkushtim të SBASHK-ut për të rikthyer jetën dhe gjallërinë në shkollat e Kosovës. “Nuk ishte e lehtë sepse çdo gjë ishte e shkatërruar e djegur në komunën e Pejës nga dora e pushuesit. Nxënësit erdhën në shkollë, por zemrat i kishin të lënduara sepse u mungonin të afërmit dhe po jetonin në kushte tepër të vështira e shumë prej tyre edhe pa kulm mbi kokë. “I jepnim forcë njëri-tjetrit dhe me nxënësit flisnim për ardhmërinë dhe lartësonim kujtimin për ata që me pendë e me pushkë i sollën lirinë atdheut. Shprehnim bashkë edhe respekt të lartë për miqtë ndërkombëtar që ndihmuan që dielli i lirisë të agojë në Kosovë.

Duke biseduar për situatën aktuale, Isufi kujton edhe trajnimet e shumta të organizuara për punëtorët e arsimit në Pejë, trajnime këto që janë kryer me sukses falë përkushtimit të stafit qendror të SBASHK-ut, të kryesisë së sindikatës në Pejë dhe përkushtimit të trajnerëve. “Trajnimet janë vetëm njëri nga aktivitetet e SBASHK-ut. Këtu duhet kujtuar edhe lidhja e më shumë se 100 marrëveshjeve me institucione private shëndetësore, të rekreacionet, por edhe me biznese për zbritje të çmimeve të shërbimeve për anëtarësinë tonë. Është i qëlluar shumë edhe aktiviteti tradicional për të dërguar në bregdetin shqiptar të një numri të konsideruar të anëtarëve të SBASHK-ut. Ky aktivitet u ka mundësuar shumë prej të punësuarve që të kalojnë qaste të mrekulluara buzë valëve të detit dhe të takohen atje me kolegë, që dikur kanë qenë në studime e nuk janë takuar më me vite.

“Ka edhe shumë aktivitete e angazhime të SBASHK-ut në shërbim të anëtarësisë. SBASHK-u ishte dhe mbetet zë i fuqishëm i të punësuarve në arsim dhe prandaj të gjithë duhet të jemi bashkë e në SBASHK”, vlerëson Isufi.

Gjatë muajit

Një aktivitet i veçantë me Qendrën Amerikane të Solidaritetit **SBASHK njihet me përvojat amerikane për grevat dhe protestat**

Duke dëshmuar gjithë respektin për angazhimet dhe përkushtimin e SBASHK-ut në shërbim të anëtarësisë, Qendra Amerikane e Solidaritetit me seli në Tiranë vazhdon bashkëpunimin me sindikatën tonë duke organizuar trajnime e seminare që kanë për qëllim forcimin e zërit sindikal.



Me angazhimin e drejtorit të kësaj Qendre Steven McCloud u realizua seminar 3 ditor me pjesëmarrjen e udhëheqësve sindikalë nga të gjitha nivelet. Kishte ardhur nga Uashingtoni gazetarja dhe drejtoresha për komunikim në Qendrën Amerikane të Solidaritetit Kate Conradt për të dhënë kontribut të çmuar në rrjedhën e mbarë të këtij aktiviteti.



Ajo në fillimet e punimeve të këtij seminari ka prezantuar një studim përmbajtjesor lidhur me grevat e mësuesve në SHBA duke përcjellë te pjesëmarrësit përvojat e sindikalistëve nga Amerika për organizimin e protestave dhe grevave dhe për format se si krijohet atje mesazh i fuqishëm për opinionin lidhur me këto veprime sindikale.



Kryetari Rrahman Jasharaj bashkë me përfaqësuesit tjerë të SBASHK-ut kanë falënderuar drejtorin e Qendrës Amerikane të Solidaritetit z. Steven dhe znj. Conradt për bashkëpunimin dhe kontributin me vlerë duke shprehur mirënjohje që ajo solli përvojat e grevave të mësuesve në SHBA e pastaj kanë treguar për përvojat e shumta të SBASHK-ut lidhur me organizimin e protestave e në veçanti të grevave në përpjekje për të realizuar kërkesat legjitime të anëtarësisë.

Kryetari Jasharaj duke përcjellë disa nga përvojat nga greva e fundit 5 javore veçoi se Kryeministri dhe Qeveria e Kosovës kanë qasje të gabuar ndaj sindikatave dhe i ikin vazhdimisht dialogut dhe prandaj edhe kanë ndodhur protesta e greva aq e gjatë në tërë sistemin arsimor.

Conradt, McCloud me bashkëpunëtorët e tyre për tri ditë me radhë kanë shpalosur tema nga aktualiteti në arsimin në vende të Ballkanit, Evropës, SHBA e kudo në botë për të zhvilluar bashkëbiseda me pjesëmarrësit.



Ky seminar ka pasur rrjedhë të mbarë dhe kontribut të çmuar kanë dhënë përfaqësuesit e SBASHK-ut duke marrë pjesë aktive në bashkëbiseda e duke treguar për shumë nga aktivitetet e zhvilluara të SBASHK-ut nëpër vite për çka edhe kanë marrë vlerësime të larta nga drejtoresha për komunikim në Qendrën Amerikane të Solidaritetit Kate Conradt dhe nga drejtori i kësaj qendre me seli në Tiranë Steven McCloud.



Kuvend zgjedhor në Skenderaj

Respekt për angazhimet e kolegut Polaci, përgëzime Kryetarit të ri Shpend Rexha

Në Skenderaj, të shtunën e 13 majit, është mbajtur Kuvend zgjedhor i Sindikatës së Arsimit Parauniversitar për këtë komunë.

Ky Kuvend zgjedhor është mbajtur me kërkesën e kryetarit Ramiz Polaci, i cili është pensionuar dhe ka shprehur dëshirë që detyrën e tij ta marr ndonjëri nga kolegët që merr besimin e pjesëmarrësve të Kuvendit.



Kryetari Polaci në hapje të këtij Kuvendi zgjedhor ka falënderuar pjesëmarrësit dhe veprimtarët sindikalë për angazhimet e përbashkëta në shërbim të anëtarësisë gjatë dy viteve të kaluara. Polaci ka shprehur respekt të lartë për kryetarin e SBASHK-ut Rrahman Jasharaj, për stafin qendror dhe për kryetarët e nivelit komunal sindikal e të Universiteteve, të cilët, siç theksoi ai, bashkërisht e me përkushtim të lartë janë angazhuar për realizimin e kërkesave të anëtarësisë duke u përballur me shumë sfida të kohës. Polaci pastaj ka prezantuar edhe Raportin e punës për dy vitet e kaluara duke u ndalur



në disa prej angazhimeve konkrete dhe duke kujtuar edhe arritjet në përpjekjet për realizimin e kërkesave të anëtarësisë. Ai pastaj ka prezantuar edhe Raportin financiar dhe pastaj pjesëmarrësit kanë aprovuar të dy këto raporte.

Në vazhdim të punimeve të këtij Kuvendi kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj ka falënderuar pjesëmarrësit për angazhimet dhe unitetin e treguar e pastaj është shprehur se ndjehet krenar që gjatë rrugëtimit sindikal ka pasur bashkëpunim të shkëlqyer



me kryetarin Ramiz Polaci duke veçuar angazhimin dhe kontributin e lartë të kolegut Polaci në të gjitha angazhimet e SBASHK-ut në nivel komunal, por edhe në nivelin qendror. “Në momentet plot sfida kam gjetur mbështetje të vazhdueshme nga Ramizi dhe gjithë kolegët nga Skenderaj dhe e gjithë Kosova dhe kjo më ka bërë që të ndjehem nga njerëzit me krenar dhe të përballoj më lehtë sfidat e kohës”, është shprehur Jasharaj. Pas kësaj është zhvilluar procesi i votimit të fshehtë për kryetarin e ri të këtij Kuvendi.

Pjesëmarrësit me votën e tyre besimin që t'i udhëheq në dy vitet e ardhshme ia kanë dhënë kolegut Shpend Rexha, i cili ka shprehur respekt të lartë për angazhimet dhe përkushtimin e kolegut Ramiz Polaci e pastaj ka premtuar se do të vazhdojë angazhimet në shërbim të anëtarësisë.

Në pjesën e dytë të këtij Kuvendi zyrtari ligjor në SBASHK Blendor Shatri u është përgjigjur pyetjeve të pjesëmarrësve duke dhënë sqarime të duhura për gjithë çështjet e ngritura.

Edhe një angazhim i SBASHK-ut në shërbim të anëtarësisë

Marrëveshje për zbritje të çmimeve për shërbime në Academic English Center

Në ambientet e SBASHK-ut përmes një ceremonie festive është nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me drejtorin e “Academic English Center” me seli në Prishtinë, z. Lavdrim Avdyli.

Para se të nënshkruhej kjo marrëveshje drejtori Avdyli ka treguar për angazhimet dhe aktivitetet që zhvillon kjo Qendër dhe pastaj ka shtuar se kjo marrëveshje

është dëshmi e respektit për SBASHK-un dhe për gjithë punëtorët arsimorë që punojnë me përkushtim për arsimimin dhe edukimin e nxënësve të Kosovës.

Kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj bashkë me nënkryetaren Vjollca Shala dhe koordinatoren për organizim të brendshëm Ymer Ymeri kanë njoftuar mysafirin për angazhimet e SBASHK-ut në shërbim të

SBASHK në mbështetje të kërkesave të Sindikatës së Re të KEK-ut **Jasharaj –Ju me sakrifica të mëdha po i jepni dritë Kosovës**



anëtarësisë për të veçuar edhe 8 trajnimet e licencuara dhe aktivitete të tjera. Kryetari Jasharaj ka falënderuar drejtorin Avdyli duke u shprehur i bindur se kjo marrëveshje do të jetë ndihmesë e mirë për anëtarët e sindikatës sonë, por edhe për anëtarët e familjeve të tyre. “Academic English Center” në objektin e saj dhe me mësimdhënës profesional do të ofrojë mundësinë për gjuhë angleze në profesion me zbritje prej 50 % nga

çmimi i caktuar nga kjo Qendër për këtë aktivitet , shumë të cilën do ta paguajnë pjesëmarrësit në programin “Gjuhë angleze në profesion”. Ky program do t’u mundësojë pjesëmarrësve ta mësojnë gjuhën angleze, gjuhë kjo e përdorur kudo në botë. Selia e kësaj Qendre gjendet në Prishtinë, në rrugën Sylejman Vokshi, nr. 76/7. Komunikimi me Qendrën mund të bëhet edhe në tel. 045 923 695.



Aktivitet i veçantë i sindikatave të Ballkanit në Maqedoninë e Veriut **I pranishëm edhe Ministri i Arsimit të Maqedonisë së Veriut Jeton Shaqiri**

Kishin punuar gjatë duke bërë hulumtime lidhur me sigurinë në punë dhe mbrojtjen e shëndetit të punëtorëve arsimor. Për të prezantuar këto gjetje dhe për të këmbyer përvoja për këtë temë tepër të rëndësishme Sindikata e Arsimit, Kulturës dhe Shkencës e Maqedonisë së Veriut ka organizuar në Shkup Konferencën përmbyllëse. I pranishëm në këtë aktivitet ishte edhe Ministri i Arsimit të Maqedonisë së Veriut Jeton Shaqiri, i cili para fillimit të kësaj Konference është ndalur në një bashkëbisedë me kryetarin e SBASHK-ut Rrahman Jasharaj dhe koordinatoren për organizim të brendshëm Ymer Ymeri duke u interesuar për gjendjen aktuale në arsimin e Kosovës.



Në fillimet e punimeve të Konferencës kryetari i Sindikatës së Arsimit të Maqedonisë së Veriut Joakim Nedelkov ka përshëndetur pjesëmarrësit për të shpalosur

pastaj angazhimet dhe për të treguar edhe për sfidat dhe arritjet e kësaj sindikate. Ai ka treguar se hulumtimet e bëra Sindikata dhe Asociacioni i Maqedonisë për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit.



Rezultatet e këtij hulumtimi i ka prezantuar pastaj përgjegjësi i këtij Asociacioni Milan Petkovski duke nxitur pjesëmarrësit të marrin pjesë aktive në debat lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me sigurinë në institucione arsimore dhe për faktorët që ndikojnë në shëndetin e punëtorëve arsimor për të veçuar presionet, stresin dhe kushtet e punës. Ministri i Arsimit të Maqedonisë së Veriut ka përgëzuar sindikatën për këtë aktivitet dhe është shprehur i lumtur që sindikata e arsimit të Maqedonisë së veriut ka bashkëpunim të shkëlqyer me sindikatën e arsimit nga Kosova dhe nga shtete të tjera të Ballkanit.



Kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj ka falënderuar mikpritësin për organizimin e këtij aktiviteti e pastaj ka shprehur kënaqësinë për bashkëpunimin e shkëlqyer në mes të sindikatave të këtyre dy shteteve. Ai ka kujtuar se të dy sindikata në përpjekje për të realizuar kërkesat e anëtarësisë kanë bërë shumë angazhime dhe veprime sindikale dhe gjithmonë kanë mbështetur moralisht njëra-tjetrën. “Fati dhe gjendja aktuale e arsimit në shumë nga shtetet e Ballkanit është i njëjtë dhe prandaj duhet forcuar bashkëpunimin mes sindikatave duke shtuar solidaritetin dhe mbështetjen për cilëndo nga sindikatat që gjendet

në veprime sindikale duke u përpjekur për realizimin e kërkesave legjitime të anëtarësisë”, ka deklaruar kryetari Jasharaj.

Përfaqësuesit sindikatave të arsimit nga disa vende të Ballkanit kanë treguar për situatën aktuale të arsimit në shtetet e tyre duke treguar se një sfidë e madhe është edhe siguria jo e duhur në institucione arsimore dhe për kujdesin e munguar ndaj shëndetit të punëtorëve të arsimit e duke kërkuar që të ketë çdo vit aktivitet të organizuar nga institucione shëndetësore për të parë nga afër shëndetin momental të punëtorëve arsimor në të gjitha nivelet. Delegacioni i SBASHK-ut ka zhvilluar takime të ndara shumë nga delegacionet e sindikatave duke këmbyer ide për angazhimet sindikale në të ardhmen.



Me kohë filluan përgatitjet për një aktivitet tradicional

Pushim në bregdetin shqiptar për më shumë se 400 anëtarë të SBASHK-ut

Duke u bazuar në mundësitë buxhetore dedikuar realizimit të aktivitetit tradicional për organizimin e pushimeve në bregdetin shqiptar në SBASHK kanë filluar me kohë përgatitjet me qëllim që ky aktivitet të ketë rrjedhë të mbarë sikur edhe në vitet e kaluara.

Kryesia e SBASHK-ut e autorizuar nga takimet me kryetarët e nivelit komunal sindikal e të Universiteteve kanë caktuar kriteret në të cilat duhet bazuar shoqatat sindikale me qëllim të përzgjedhjes së drejtë të pushuesve dhe ato u janë shpërndarë shoqatave që e kanë radhën të bëjnë përzgjedhjen e pushuesve nga mesi i anëtarësisë së tyre. Po ashtu është autorizuar koordinatori për organizim të brendshëm që në cilësinë e kryetarit të komisionit përgatitor të bëjë gjithë përgatitjet e duhura për realizimin e këtij aktiviteti. Këto përgatitje ai i ka nisur me kohë duke pasur mbështetjen e tërë stafit në SBASHK.

Për momentin përgatitjet janë fokusuar te përgatitja e grupit të parë për të cilët pushimi në bregdetin shqiptar do të fillojë më 15 qershor.

Në stafin qendror janë optimist se ky aktivitet do të ketë rrjedhë të mbarë sikur edhe viteve të kaluara dhe se pushuesit do të kthehen me përshtypje të shkëlqyera nga ditët e kaluar në shoqëri me valët e qeta të detit shqiptar në Durrës.

